



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
KOMUNA-MALISHEVË / DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE**

Nr. **145**

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

Datë: 24.09.2021

Në bazë të nenit 67 të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr. 06/L-114. Ligjit të Punës të Republikës së Kosovës nr. 03/L-212. Udhëzimit Administrativ të (MPMS) nr. 07/2017. Ligjit për Shëndetësi nr. 04/L-125. Udhëzimit Administrativ nr. 04/2020 Për Kujdesin Parësor Shëndetësor dhe nenit 10 të Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare-Malishevë. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale shpall këtë:

**KONKURS
TË MBRENDSHËM
PËR PLOTSIMIN E VENDIT TË LIRË TË PUNËS.**

Pozita: Drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare- Malishevë

Institucioni:	Komuna e Malishevës
Kategoria Funksionale	Nivel drejtues.
Numri i Pozitave	(1) një.
Titulli i mbikëqyrësit	Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
Grada/ Koeficienti	H -3- 944/1
Kohëzgjatja e emërimit	Me kohë të caktuar (mandat 4 vjeçar).
Orari i Punës	40 orë në javë

DETYRAT KRYESORE TË PUNËS:

- Siguron Ligjshmërinë dhe punën profesionale në QKMF, e cila duhet të udhëhiqet në pajtim me dispozitat e Statutit të QKMF-së
- Është përgjegjës për përkujdesjen efektive të Shëndetësisë parësore për të gjithë banorët e Komunës së Malishevës.
- Në pajtim me Politikën Shëndetësore, Ligjin për Shëndetësi në Kosovë dhe Strategjinë e Kujdesit Parësor Shëndetësor, i propozon Drejtoratit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale planin e punës dhe buxhetin e QKMF-së për vitin vijues.
- Kujdeset për udhëheqjen e përditshme të procesit të punës.
- Kujdeset për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të personelit të QKMF-së
- Kontribuon në zhvillimin e sistemit të informimit shëndetësor të QKMF-së.
- Ushtron të drejta dhe autorizime dhe mban përgjegjësi të tjera në përputhje me dispozitat ligjore dhe aktet e tjera që kanë të bëjnë me implementimin e Mjekësisë Familjare.

KUSHTET:

- Aftësi të plotë për përmbushjen e detyrave të vendit të punës, me orar të plotë pa kufizime dhe pengesa ligjore.
- Përgatitje universitare: Fakulteti i Mjekësisë- Specialist i mjekësisë familjare.
- Aftësi të mira analitike dhe komunikuese.
- Të ketë përvojë pune nga fusha e menaxhimit dhe zbatimit të mjekësisë familjare.
- Njohja e gjuhës angleze e dëshirueshme.
- Njohuri të punës me kompjuter.
- Aftësi të tjera që shërbejnë për kryerjen e detyrave të punës dhe raport kolegjial në marrëdhënie pune.

DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM:

- Dokumentet personale Cv:
- Diplomë universitare- Specialist i Mjekësisë Familjare (kopje).
- Licencë pune të lëshuar nga organi kompetent (kopje).
- Certifikatën që nuk është nën hetime nga Gjykata (origjinali)
- Dëshmi për përvojë pune në shëndetësi (5 pesë vite). Origjinali
- Vërtetim mbi gjendjen shëndetësore të lëshuar nga institucioni publik shëndetësor (pas përzgjedhje nga Komisioni).
- Dokumentet të cilat dorëzohen kopje duhet të janë në origjinal ditën e intervistimit me shkrim.

Afati dhe mënyra e aplikimit:

30 ditë nga dita e publikimit të konkursit mbetet vetëm njoftim, ndërsa konkursi mbetet i hapur 15 ditë.

Aplikacionet dorëzohen nga data 25.10.2021 deri me dt: 08.11.2021 Aplikacionet merren dhe dorëzohen ne Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (ditëve të punës prej: 08 deri ora 16).

Të gjithë kandidatët të cilët i kanë mbaruar studimet jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës si dhe nëpër kolegje private brenda Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këtë pozitë duhen që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.

- Konkursi shpallet në linkun: <http://konkursi.rks-gov.net>
- Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe dokumentet e pa kompletuara nuk do të pranohen.

DSHMS -Malishevë.

Drejtori DSHMS-së

Liridon Hoti

